



KËSHILLI DREJTUES

VENDIM QARKULLUES

Nr. 34, datë 27.11.2020

Mbi miratimin e

**“Rregullores për hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit të
Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 44 pika 1, shkronja “a”, të nenit 52, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr.53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 7, pika 6 dhe të nenit 8, pika 2, shkronja “k” të Statutit të Agjencisë, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 10, pika 6 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm,

V E N D O S I:

1. Të miratojë “Rregulloren për hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të shfuqizojë Rregulloren “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të ASD”, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.56, datë 29.9.2003, të ndryshuar.
3. Ngarkohen të gjitha njësitë organizative të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar